



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues

AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. K4 / I50-2 Prot.
Nr. Dok. 202502872/2

Tiranë 17/12/2025

Lënda: Rekomandim për inspektimin e kryer në Shtëpinë e të Moshuarve në
Tiranë

Drejtuar: BASHKISË TIRANË

TIRANË

SHËRBIMIT SOCIAL SHTETËROR

TIRANË

SHTËPISË SË TË MOSHUARVE

TIRANË

Të nderuar,

Avokati i Popullit, vlerëson bashkëpunimin e deritanishëm dhe angazhimin dhe punën e të gjithë stafit të institucionit që ju drejtoni, si dhe frymën e mirë të bashkëpunimit dhe mirëkuptimit midis institucioneve tona. Në vijim po ju njohim mbi gjetjet dhe rekomandimet nga inspektimi i kryer në Shtëpinë e të Moshuarve në Tiranë, më datë 5.06.2025.

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, Trajtimit ose Dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, në vijim **MKPT**, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, inspektoi Shtëpinë e të Moshuarve në Tiranë sipas Planit të Inspektimit për vitin 2025 të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin znj. Gloria Çarkaxhiu dhe znj. Nertila Qafzezi me detyrë nd/komisionere pranë Mekanizmit Kombëtar.

Qëllimi i kësaj vizite ishte vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së këtij shërbimi, ndjekja e rekomandimeve të lëna nga vizitat e mëparshme nga institucioni i Avokatit të Popullit dhe masat e marra për zbatimin e tyre, mbledhjen e informacionit lidhur me kushtet dhe trajtimin e të moshuarve, si dhe identifikimin e rasteve të mundshme të përdorimit ndaj kësaj kategorie të presionit psikologjik dhe përdorimin e forcës

fizike tej kufijve në tejkalim të standardeve, apo dhe mbajtjen në qendra rezidenciale pa vullnetin e tyre. Vizita ishte e paparalajmëruar.

Avokati i Popullit, pasi shqyrtoi informacionin nga monitorimi i realizuar, ka detyrimin ligjor, t'ju parashtrojë përfundimet e këtij monitorimi, si më poshtë vijon.

Objektivat e inspektimit:

- Vlerësimi i dokumentacionit, procedurave dhe personelit, në zbatim të legjislacionit në fuqi;
- Zbatimi i rekomandimeve të lëna nga Avokati i Popullit në vitin 2024 si dhe gjendja aktuale;
- Respektimi i të drejtave të personave të moshuar, të cilët janë akomoduar në këtë institucion rezidencial, në zbatim të standardeve ligjore, të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për të moshuarit.

Metodologjia

Grupi i inspektimit i përbërë nga një jurist dhe një psikologe si metodologji pune ka përdorur:

- ***Së pari***, zhvillimin e bisedave paraprake me Drejtorin e Qendrës dhe përgjegjësen e sektorit social, informacion, i cili është hedhur në një formular standard për inspektimin.
- ***Së dyti***, monitorimin e zbatimit të standardeve ligjore të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për qendrat rezidenciale për të moshuarit.
- ***Së treti***, monitorimin e mjediseve dhe kushteve të institucionit (Shtëpia e të Moshuarve në Tiranë), ku ofrohen shërbime për personat e moshuar.
- ***Së katërti***, komunikimi me disa të moshuar, përfitues të shërbimeve të përkujdesjes, të akomoduar në Shtëpinë e të Moshuarve në Tiranë.

Rekomandimet e vitit 2024 dhe niveli i zbatimit të tyre

Nga inspektimi i mëparshëm i kryer në Shtëpinë e të Moshuarve në Tiranë, për problemet e konstatuara, Avokati i Popullit ka rekomanduar¹:

1. Marrjen e masave përkatëse për shtim në organikë të pozicioneve të punës me 2 (dy) infermiere me kohë të plotë dhe të rojes së objektit.
2. Marrjen e masave nga Shërbimi Social Shtetëror për shtim fondi buxhetor, në parashikimet e buxhetit për vitin 2025 për Shtëpinë e të Moshuarve Tiranë, me qëllim mirëmbajtjen e institucionit dhe blerjen e pajisjeve përkatëse sipas nevojave.
3. Marrjen e masave për krijimin e një mjedisi terapeutik me pajisje speciale për të moshuarit që janë me probleme shëndetësore.

¹ Rekomandim nr. K4/I46-2-2 prot, datë 24.12.2024, “Rekomandim për inspektimin e kryer në Shtëpinë e të Moshuarve në Tiranë”.

4. Marrjen e masave nga Shërbimi Social Shtetëror, për kryerjen e trajnimeve për stafin e Shtëpisë së të Moshuarve, Tiranë.
5. Marrjen e masave menjëherë nga Drejtori i Shtëpisë së të Moshuarve Tiranë, që kampionet ushqimorë të ruhen të etiketuara sipas standardeve të përcaktuara.

Në përgjigje të rekomandimeve të sipërcituara, Shërbimit Social Shtetëror ka informuar² si më poshtë:

- *Për rekomandimin nr.1*, për marrjen e masave përkatëse për shtim në organikë të pozicioneve të punës me 2 (dy) infermierë me kohë të plotë dhe të rojes së objektit, Shërbimi Social Shtetëror sqaron se Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në bashkëpunim me SHSSH dhe institucionet e përkujdesit, me Urdhër Ministri 251/2023 për rishikimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror, me asistencën teknike të Programit të Mbështetjes Buxhetore “Përfshirja Sociale” EU4SI, ka hartuar dhe janë miratuar, standardet e rishikuara të shërbimit rezidencial për të moshuar, me Udhëzimin nr. 168, datë 29.03.2024 “Për miratimin e standardeve të shërbimit të përkujdesit shoqëror për të moshuar në qendrat rezidenciale dhe manuali i zbatimit”. Nisur sa më sipër grupi i punës është në proces të pasurimit të standardeve specifike për këtë shërbim, në bazë të numrit të përfituesve. Sa më sipër, me t’u hartuar dhe miratuar këto standarde do të rishikohen të gjitha organikat e qendrave rezidenciale publike për të moshuar, përfshirë këtu Shtëpinë e të Moshuarve Tiranë.
- *Lidhur me rekomandimin nr.2*, për marrjen e masave për shtim fondi buxhetor, në parashikimet e buxhetit për vitin 2025 për Shtëpinë e të Moshuarve Tiranë, më qëllim mirëmbajtjen e institucionit dhe blerjen e pajisjeve përkatëse sipas nevojave, sqarojmë se: SHSSH duke marrë parasysh kërkesat e institucioneve të paraqitura në projekt buxhet bën akordimin e fondeve në total për vitin pasardhës për institucionet e varësisë. Fondi i kërkuar dhe akorduar ka ardhur çdo vit në rritje referuar dhe tavaneve përfundimtare të shpenzimeve të PBA-së 2025-2027. Gjithashtu, gjatë Fazës II programi buxhetor afatmesëm për vitin 2025-2027 Shtëpia e të Moshuarve Tiranë ka dërguar kërkesën për investime në pajisje elektrike të cilën SHSSH në bashkëpunim me MSHMS gjatë vitit 2025 do ta realizojnë.
- *Lidhur me rekomandimin nr.3*, për marrjen e masave për krijimin e një mjedisi terapeutik me pajisje speciale për të moshuarit që janë me probleme shëndetësore sqaroni se: SHSSH në Fazën II Programi Buxhetor Afatmesëm për vitin 2025-2027 administroi kërkesat për investime nga institucionet e varësisë, hartoi listën përmbledhëse dhe e dërgoi pranë MSHMS. Gjatë vitit 2025 MSHMS ka miratuar zërin për investime blerje pajisje për institucionet dhe do të vijohet me realizimin e procedurës.

² Shkresa nr. 10013/1 prot., datë 10.01.2025, “Kthim përgjigje”.

- *Lidhur me rekomandimin nr.4, për marrjen e masave nga Shërbimi Social Shtetëror, për kryerjen e trajnimeve për stafin e Shtëpisë së të Moshuarve, Tiranë, sqaroni se: SHSSH ka realizuar bashkëpunim me European Commission, Sue Ryder Care Albania dhe Bashkinë Tiranë për trajnimin e Përgjegjësve Socialë dhe Psikologëve të institucioneve rezidenciale dhe ditore për të moshuarit, trajnim 3 (tre) ditor (20, 21 dhe 22 maj 2024), me temë “Fuqizimi i kujdesit për të moshuarit: Një qasje gjithëpërfshirëse për ofrimin e shërbimeve të mirëkoordinuara për të moshuarit”. Në këtë trajnim kanë marrë pjesë Përgjegjësia e Sektorit Social dhe Psikologu i Shtëpisë së të Moshuarve Tiranë. Ndërkohë që SHSSH në planin e punës për vitin 2025 do të ketë në objektivat e tij dhe trajnimin e stafeve të institucioneve rezidenciale për të moshuar lidhur me zbatimin e standardeve të reja për të moshuarit, dalë me Udhëzimin nr. 168, datë 29.03.2024, “Për miratimin e standardeve të shërbimit të përkujdesit shoqëror për të moshuar në qendrat rezidenciale dhe manuali i zbatimit”.*

Gjithashtu këto rekomandime i janë drejtuar edhe Bashkisë Tiranë, e cila nuk ka kthyer përgjigje për rekomandimet e Avokatit të Popullit.

Lidhur me zbatimin e rekomandimeve, rezultoi se:

- **Nuk** ishin marrë masa për shtimin e organikës me 2 (dy) infermiere me kohë të plotë.
- **Nuk** ishin marrë masat për krijimin e një mjedisi terapeutik me pajisje speciale për të moshuarit që janë me probleme shëndetësore
- **Nuk** ishin marrë masa nga Shërbimi Social Shtetëror, për kryerjen e trajnimeve për stafin e Shtëpisë së të Moshuarve, Tiranë.
- **Nuk** ishin marrë masat nga Shërbimi Social Shtetëror për shtimin e fondit buxhetor, në parashikimet e buxhetit të vitit 2025 për Shtëpinë e të Moshuarve Tiranë, me qëllim mirëmbajtjen e institucionit dhe blerjen e pajisjeve përkatëse sipas nevojave.
- **Ishin** marrë masat për shtimin e organikës me një roje me kohë të pjesshme ndërkohë.
- **Ishin** marrë masat për etiketimin e kampionëve ushqimorë sipas standardeve të përcaktuara.

Sipas informacionit të administruar përgjatë inspektimit u informuam se, organizata “GIZ” dhe familjarët e të moshuarve kanë dhuruar për Shtëpinë e të Moshuarve Tiranë katër shtretër spitalorë të cilët janë vendosur në dispozicion të të moshuarve sipas nevojave shëndetësore të tyre.

Shtëpia e të Moshuarve Tiranë me shkresën nr. 92 prot., datë 25.03.2025 me lëndë *“Kërkesë për investim mbi hartimin e projekt buxhetit për vitin 2025-2027”*, drejtuar SHSSH ka dërguar kërkesën për investim mbi hartimin e Projekt Buxhetit për vitin 2026-2028 FAZA e I *“...mbi domosdoshmërinë e riparimit të çatisë së godinës, pasi është e dëmtuar në masën 70%, duke sjellë një rrezik potencial për sigurinë dhe komoditetin e të moshuarve të cilët ndodhen nën kujdesin e Shtëpisë së të Moshuarve Tiranë. Ky investim është thelbësor për një mjedis të sigurt dhe të qendrueshëm për të moshuarit dhe për të garantuar vazhdimësinë e shërbimeve në përputhje me standardet e kërkuara për kujdesin dhe mbrojtjen e kësaj kategorie”*. Gjithashtu, kërkesa vijon edhe me nevojën për mbështetjen e institucionit me 7 kondicionerë dhe 12 frigoriferë.

Avokati i Popullit vlerëson përpjekjet e institucionit për të siguruar ndihma për të përmirësuar kushtet e akomodimit të të moshuarve, por nga ana tjetër duhet të ketë buxhet të mjaftueshëm për të përmirësuar kushtet e jetesës dhe ato infrastrukture, me qëllim garantimin e të drejtave të njeriut dhe përmirësimin e standardeve të përkujdesit shoqëror për të moshuarit në qendrat rezidenciale. Avokati i Popullit konstaton se rekomandimet janë të përsëritura, kanë implikime buxhetore dhe duhet të trajtohen me kujdes nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale që realizon mbështetjen financiare.

Gjetjet e evidentuara përgjatë inspektimit

Shtëpia e të Moshuarve në Tiranë, është një institucion rezidencial dhe ofron shërbime të përkujdesjes për të moshuar në nevojë, të cilët kanë mbushur moshën për pension pleqërie, sipas legjislacionit në fuqi.

Ky institucion është nën administrimin e Shërbimit Social Shtetëror. Mbështetja financiare është e garantuar nga fondet e buxhetit të shtetit, nga programet e mbrojtjes sociale të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nëpërmjet Shërbimit Social Shtetëror. Institucioni është përgjegjës për mbarëvajtjen e punës dhe raporton për problematika të ndryshme pranë Shërbimit Social Shtetëror.

Shtëpia e të Moshuarve në Tiranë, ofron shërbime sipas standardeve të miratuara për personat e moshuar, të cilët janë të vetmuar apo të braktisur, dhe që kanë nevojë për kujdes të vazhdueshëm, sipas verifikimeve të kryera nga punonjësi social në njësinë e qeverisjes vendore për vlerësimin dhe referimin e rastit.

Organizimi dhe funksionimi i këtij institucioni, së bashku me përshkrimet e punës, të drejtat dhe detyrimet e përfituesve, janë të parashikuara në Rregulloren e Brendshme të tij, e cila është e afishuar në ambientet e institucionit.

Monitorimi i zbatimit të standardeve të ofruara të shërbimeve sociale kryhet nga Shërbimi Social Shtetëror, Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Tiranë, Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, Instituti i Higjienës, Agjencia Kombëtare e Ushqimit etj.

Numri i përfituesve nga shërbimet e ofruara.

Nga konstatimi paraprak u evidentua se në Shtëpinë e të Moshuarve në Tiranë akomodohen dhe ofrohen shërbime për persona të moshuar, mbi moshën 60 vjeç për gra dhe 65 vjeç për meshkuj, sipas legjislacionit në fuqi dhe plotësojnë të gjitha kushtet e përcaktuara në VKM Nr. 518 datë 4.9.2018³.

Kapaciteti i institucionit për ofrimin e shërbimeve është për 50 persona të moshuar.

Gjatë inspektimit u evidentua se në këtë institucion trajtohen 49 të moshuar, nga të cilët 23 gra dhe 26 burra. Nga dokumentacioni rezulton se 24 të moshuar janë me familje, ndërsa 25 të moshuar janë pa familje.

Pjesa më e madhe e të moshuarve rreth 85% janë me probleme shëndetësore kronike, 8 persona janë me probleme të rënda shëndetësore. Kartelat individuale për gjithësecilin administrohen nga mjeku i familjes, i cili është edhe mjek part-time pranë institucionit.

Përfitues të pensionit të pleqërisë janë 48 të moshuar dhe përfitues i ndihmës ekonomike 1 i moshuar.

Nga lista e medikamenteve që u administrua nga grupi i inspektimit, rezultoi se shumica e medikamenteve me të cilat trajtoheshin të moshuarit ishin të rimbursueshme dhe u jepeshin rregullisht. Furnizimi bëhet 2 herë në vit dhe është i mjaftueshëm sipas kërkesave të të moshuarve, të cilët nuk paraqitën ankesa ndaj stafit për këtë shërbim. Gjithashtu, në ambientet e infermierisë u kontrollua dhe sasia e ilaçeve që ishte në dispozicion, të cilat ishin brenda afatit të skadencës.

Burimet njerëzore

Struktura e përcaktuar e personelit të këtij institucioni rezidencial përbëhet nga 23 punonjës nga të cilët janë me kohë të plotë 15 punonjës dhe me kohë të pjesshme 9 punonjës përkatësisht: 1(një) mjek, 1(një) sanitare, 1(një) ndihmës/kuzhinierë, 4(katër) kujdestarë, 1 (një) mirëmbajtës dhe 1 (një) roje.

Gjatë turnit të parë punojnë 2(dy) sanitare, 1(një) kujdestare (infermiere) dhe 1(një) sanitare e 1 (një) roje të cilët punojnë me kohë të pjesshme.

Gjatë turnit të dytë punojnë vetëm 2 (dy) kujdestare.

Gjatë turnit të tretë punon vetëm një kujdestare dhe vetëm disa ditë arrihet që puna të mbulohet me 2 (dy) kujdestare.

³Pika 58. "Shërbimi në strehëza për të moshuarit, sipas përcaktimit të pikës 11/c/iii, të kreut II, të këtij vendimi, përfitohet nga subjektet që plotësojnë këto kritere: a) përfituesit e shërbimit kanë mbushur moshën për pensionsipas legjislacionit në fuqi; b) përfitojnë pension social ose pension minimal në përputhje me legjislacionin përkatës; c) nuk zotërojnë banesë apo llogari bankare; ç) janë të vetmuar dhe të braktisur sipas verifikimeve të kryera nga punonjësi social në njësinë e qeverisjes vendore për vlerësimin dhe referimin e rastit".

Me trajtimin e problemeve psiko-sociale, të përfituesve të shërbimeve të ofruara është e ngarkuar 1(një) punonjëse sociale, 1 (një) psikologe dhe mjeku.

Shërbimet shoqërore ofrohen nga 7 kujdestarë nga të cilët 4 (katër) me kohë të pjesshme.

Shtëpia e të Moshuarve Tiranë vizitohej nga një mjek çdo ditë jave për gjashtë orë.

Shërbimi dentar realizohet individualisht, nga vetë të moshuarit, me shpenzimet e tyre dhe jo me fondet e institucionit.

Me gjithë ndyshimet e fundit në personel që konsistuan në rritjen e orës së punës të punonjësve që punonin part time nga 4 orë në ditë është bërë 6 orë në ditë, nga biseda me të moshuarit konstatuam se ata kishin nevojë për shërbime të shtuara, sidomos gjatë orarit të mbasdites.

Sa më lart, struktura e Shtëpisë së të Moshuarve Tiranë nuk siguron plotësisht numrin e nevojshëm të personelit në përputhje me nevojat e tyre, pasi nuk plotësohet standardi për raportin e numrit të personelit me numrin e të moshuarve (1 kujdestar për 5 të moshuar).

Përgjatë inspektimit konstatuam se numri i punonjësve që ofrojnë shërbime shoqërore në këtë qendër është i pamjaftueshëm, edhe për faktin se nëpër këto qendra ka shumë të moshuar të sëmurë kronik dhe të paaftë për t'u kujdesur për veten. Të moshuarit ankoreshin që nuk kishte staf mjaftueshëm për t'ju ofruar shërbim në kohë reale. Në mënyrë që të ofrohet një shërbim cilësor nevojitet shtimi i numrit të punonjësve të paktën me 2 (dy) infermiere.

Për realizimin e shërbimeve apo detyrave, kujdestari për të moshuar duhet të zotërojë njohuri që kanë të bëjnë me: ndihmën e parë për individët e moshuar, me kujdesjen trupore personale, me zbatimin e procedurave të ushqyerjes, të zhveshjes- veshjes, të larjes, të dhënies së medikamenteve, etj. Shërbimet shoqërore ofrohen nga kujdestarë të cilët nuk kanë mbaruar të gjithë një shkollë të mirëfilltë për profesionin e infermierit. për të zbatuar në mënyrë sa më konkrete dhe korrekte programe të përkujdesjes psiko-sociale.

Vlerësimi i punës së stafit bëhet 1 herë në vit nga drejtuesja e institucionit. Gjithashtu, u informuam se kujdestarët në institucion nuk ishin trajnuar gjatë periudhës janar-maj 2025 nga Shërbimi Social Shtetëror.

Avokati i Popullit thekson se, duke pasur parasysh natyrën sfiduese të punës së tyre dhe nevojat e banorëve, është me rëndësi thelbësore që stafi kujdestar të marrë trajnime të vazhdueshme për punën e tyre.

Një nga vështirësitë e punës për personelin janë mungesa e hapësirave dhe aksesit për të kryer shërbimin sipas standardeve, përfshirë dhe mungesën e një mjedisi terapeutik me pajisje speciale për të moshuarit që janë me probleme shëndetësore.

Ambientet e Shtëpisë së të Moshuarve në Tiranë

Shtëpia e të Moshuarve në Tiranë ndodhet në një godinë tre katëshe. Në katin e parë të kësaj godine gjenden dhomat, ku ishin sistemuar të moshuar me probleme shëndetësore të rënda dhe mensa. Në katin e dytë gjenden disa dhoma fjetjeje për të moshuarit. Në katin e tretë gjenden dhoma të tjera fjetjeje për të moshuarit, zyrat e administratës dhe salla e aktiviteteve. Tualetet dhe dushet, ishin të përshtatura për përfituesit e këtij institucioni.

Përgjatë inspektimit konstatuam se në katin e parë të godinës së banimit kishte një prezencë të lartë të lagështirës. Ndërkohë dhomat paraqiteshin në gjëndje të mirë, ato ishin të pastra si dhe kishin dritë të mjaftueshme natyrore. Gjithashtu ishin të pajisura me shtretër dhe dollapë që tregonin që ambienti ishte i personalizuar për çdo banor. Tualetet dhe dushet gjendeshin brenda dhomave dhe ishin të kompletuara.

Të moshuarit të cilët kishin probleme shëndetësore kishin akses në përdorimin e rampave në institucion.

Institucioni planifikon çdo vit buxhet për pajisjet higjienike, batanije e çarçafë. Ndërkohë që për vitin 2025 Shtëpia e të Moshuarve Tiranë ende nuk ishte furnizuar me materialet e buta, nevojat aktuale ishin plotësuar nga blerjet e një viti më parë.

Mbështetja e pamjaftueshme financiare nga Shërbimi Social Shtetëror, për investime apo dhe riparime thelbësore, blerje elektroshtëpijakesh e mobiljesh, madje edhe sendet që lidhen me kujdesin personal, të përshtatshme për banorët dhe produktet personale, janë thelbësore për ofrimin e shërbimeve me standarde për këta banorë.

Avokati i Popullit konsideron se Shtëpisë së të Moshuarve Tiranë, duhet t'u sigurohet një buxhet financiar i mjaftueshëm, për t'u ofruar banorëve kujdes thelbësor dhe strehimin e duhur.

Në një ambient të veçantë ishin të afishuara rregulloret e jetës së brendshme, standardet që duhet të respektojnë punonjësit e këtij institucioni, si dhe ishte vendosur edhe "Kutia e ankesave", ku depozitoheshin ankesat e të moshuarve. Kutia e ankesave hapej një herë në muaj, nga përfaqësuesi i Shërbimit Social Shtetëror në praninë e një të moshuari.

Mjetet për shmangien e rreziqeve që mund të vijnë nga rastet e emergjencave civile, ishin të vendosura në vende të veçanta në korridore sipas standardeve. Kolaudimi i tyre bëhet 1 herë në vit. Stafi ishte trajnuar për përdorimin e mjeteve kundër zjarrit.

Ngrohja realizohej me kaldajë dhe ishte funksionale, ndërsa ftohja në disa dhoma me kondicionerë dhe me ventilatorë në ambientet e tjera.

Ambienti i kuzhinës ishte i pastër, i pajisur me soba profesionale, frigorifer etj. Kampionët e ushqimeve për të treja vaktet ruheshin në frigorifer dhe ishin të etiketuara me datën përkatëse por konstatuam se nevojiteshin enë guzhine të reja.

Kuota ushqimore është rritur tashmë në 430 lekë në ditë⁴, prej 360 lekësh në ditë. Shtëpia e të Moshuarve në Tiranë, për t'u siguruar banorëve një dietë të shëndetshme dhe të larmishme, duhet të ketë një buxhet të mjaftueshëm për ushqimin, për shkak dhe të rritjes së çmimeve dhe kostos së jetesës. Rritja prej 70 lekë në ditë, konsiderohet shumë e ulët dhe kjo rritje nuk ndikon as në cilësinë e as në sasinë e ushqimit⁵.

Për përcaktimin e menusë dhe oraret e vakteve të ngrënies, merrej mendimi i të moshuarve. Menuja javore firmoset nga një i moshuar, që mund edhe të ndryshohet po nga të moshuarit sipas preferencave. Një herë në muaj plotësohet pyetësori për ndryshimin e menusë dhe merret mendimi i tyre.

Në ambientin e jashtëm të godinës, ka një oborr të pajisur me stola, por duke qenë se hapësira nuk ishte e mjaftueshme për shëtitje dhe zbavitje për të moshuarit, ata lëviznin lirshëm edhe jashtë qendrës dhe kjo gjë u konfirmua edhe nga vetë të moshuarit.

Në ditën e inspektimit të moshuarit u takuan nga ana jonë në oborrin e institucionit dhe u zhvilluan biseda me ta pa praninë e stafit.

Jeta social-kulturore

Përsa i përket jetës sociale, nga informacioni që u mor gjatë inspektimit u konstatua se organizoheshin aktivitete të ndryshme, sipas një plani mujor: ditëlindje, festa fetare, festat zyrtare etj. Megjithatë, nga inspektimi vërejmë se në Shtëpinë e të Moshuarve Tiranë ka një mungesë aktiviteteve sociale të cilat mund të zhvilloheshin edhe në natyrë dhe për realizimin e tyre është e nevojshme që të parashikohet një zë i veçantë në buxhetin e institucionit.

Të moshuarit vizitohen nga të afërmit e tyre. Takimet e realizuara pasqyrohen në një regjistër të veçantë. Për të moshuarit që nuk kanë kontakte me të afërm, bëhet një punë e madhe nga stafi për të bërë të mundur kontaktimin e tyre.

Në sallën e aktiviteteve, ishte e vendosur një bibliotekë, televizor, ku të moshuarit kalonin një pjesë të kohës në mënyrë të kulturuar.

Nuk u paraqitën ankesa ndaj stafit. Të moshuarit konfirmonin gatishmërinë e stafit për të plotësuar çdo kërkesë të tyre.

⁴ Udhëzimi nr. 662, datë 06.12.2022, "Për një ndryshim në udhëzimin nr. 689, datë 02.10.2018, për nivelin e kuatove të shpenzimeve për ushqime, në Institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesit shoqëror".

⁵ Raporti i institucionit të Avokatit të Popullit "Për Standardin e Minimumit Jetik në Shqipëri". Tabela 10. Kostoja minimale e shportës ushqimore në Shqipëri sipas normës ditore të kalorive për 1 të rritur (vlera mujore 7427 lekë). Burimi INSTAT.

Problematikat e konstatuara:

- Konstatohet se nuk ka kapacitete të mjaftueshme njerëzore, të domosdoshme për të ofruar shërbimet sipas standardeve të përkujdesit shoqëror. Ka nevojë për të shtuar burimet njerëzore në shërbim të të moshuarve, veçanërisht me persona që ofrojnë përkujdesje për ta, duke qenë se vazhdon të jetë një ngarkesë e madhe puna e kujdestarëve, kjo mbetet një kërkesë edhe në vijim.
- Vazhdon të jetë problem mungesa e trajnimeve specifike për çështjet që lidhen me trajtimin e të moshuarve me probleme të rënda shëndetësore dhe që kanë vështirësi në motorikën dhe lëvizjen e tyre. Është e domosdoshme që këto trajnime të jenë të vazhdueshme, në mënyrë që, trajnimet dhe mundësitë e zhvillimit të personelit të ndikojnë në përmirësimin e kushteve të jetesës për përfituesit e kësaj qendre.
- Konstatohet se, në katin e parë të godinës kishte një lagështirë të theksuar në të gjithë perimetrin e tij. Gjithashtu edhe çatia ishte në kushte të këqija e kërkonte ndërhyrje të menjëhershme. Për shkak të moshës dhe të sëmundjeve shoqëruese të tyre është e nevojshme që institucioni krijojë kushte sa më të përshtatshme për trajtimin sa më dinjitoz të këtyre grupmoshave.
- Konstatohet se, në qendër janë të akomoduar të moshuar që janë me probleme të rënda shëndetësore dhe që nuk kryejnë dot vetëshërbimet, si rrjedhojë del e domosdoshme nevoja për të krijuar një ambient terapeutik, i cili do mund të përdoret jo vetëm për kategorinë e të sëmurëve, por edhe për të moshuarit e tjerë. Sipas rekomandimeve të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, për aktivitetin fizik të të moshuarve mbi moshën 65 vjeç, “*çdo aktivitet fizik vlen sado i vogël që të jetë*”, do të ishte i nevojshëm punësimi i një fizioterapisti në këtë qendër.

Për sa më sipër, për të plotësuar standardet e përkujdesit shoqëror për të moshuarit në institucionet rezidenciale, në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku parashikohet se: “*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike*”; si dhe të nenit 21, germa “b” të ligjit nr. 8454 datë. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet se: “*Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive,*

REKOMANDIMË:

1. Marrjen e masave përkatëse për shtim në organikë të pozicioneve të punës me 2(dy) infermierë me kohë të plotë.
2. Marrjen e masave nga Shërbimi Social Shtetëror me qëllim ndërhyrjen e menjëhershme në çatinë e institucionit, si dhe eliminimin e lagështirës në ambientet e katit të parë të godinës së Shtëpinë së të Moshuarve në Tiranë.

3. Marrjen e masave për krijimin e një mjedisi terapeutik me pajisje speciale për të moshuarit që janë me probleme shëndetësore.
4. Marrjen e masave nga Shërbimi Social Shtetëror, për kryerjen e trajnimeve të vazhdueshme për stafin e Shtëpisë së të Moshuarve në Tiranë.
5. Marrjen e masave nga Shërbimi Social Shtetëror për shtimin e fondeve me fokus rritjen e aktiviteteve për këtë grupmoshë në Shtëpinë e të Moshuarve Tiranë, si dhe për plotësimin e të gjitha nevojave për pajisje të reja dhe të domosdoshme për trajtimin me dinjitet të të moshuarve.

Në bazë të Nenit 22 të Ligjit Nr.8454 dt.04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", të ndryshuar lutemi të vihem në dijeni brenda afatit 30 ditor, për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtyre rekomandimeve.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

**KOMISIONERI
i Mekanizmit Kombëtar
për Parandalimin e Torturës
(MKPT)**

Ahmet PRENÇI

d.v